



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 04 Qershor 2008, nenit 20 dhe 23 të Ligjit të punës nr. 03/L-212, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 90 e datës 01 Dhjetor 2010 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM

Për caktimin e orarit të punës për Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe Ambulantat e Mjekësisë Familjare të Komunës

1. Me këtë Vendim përcaktohet orari i punës për Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulantat e Mjekësisë Familjare (AMF) të Komunës së Lipjanit.
2. Orari i punës për QMF-të për çdo ditë pune fillon prej orës 08:00 deri në ora 20:00, kurse ditëve të shtune prej ores 08:00 deri 15:00.
3. Orari i punës për AMF-të për çdo ditë pune fillon prej orës 08:00 deri në ora 15:00
4. Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale është përgjegjëse për zbatimin dhe mbikëqyrjen e orarit të përcaktuar.
5. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe fillon së zbatuari nga data 01.01.2017, me të njejtin do të njoftohet Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Qendrat e Mjekësisë Familjare, Ambulantat e Mjekësisë Familjare të Komunës dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës.

1Nr. 130-70000
Lipjan, më 22.12.2016

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

